

Etapat e mendimit sociologjik

Raymond Aron

Përktheu nga frëngjishtja,

Masar Stavileci

Mbi Ogyst Kontin

Pjesa e parë

Politika e shëndoshë nuk mund të ketë si qëllim t'i mashtrorë njerëzit, të cilët lëvizin nëpërmjet një shtyse të tyre, sipas një ligji po aq të domosdoshëm sa ai i tërheqjes, ndonëse më i ndryshueshëm, por ajo ka si qëllim ta lehtësojë ecjen e tyre duke i sqaruar.

"Sistemi i politikës pozitiviste ", Shtojca III, "Plani i punimeve shkencore të domosdoshme për riorganizimin e shoqërisë", 1828, f. 95)

Si sociolog, Monteskjë është, pikësëpari dhe mbi të gjitha, i vetëdijshëm për diversitetin njerëzor dhe shoqëror. Për mendimin e tij, shkencë synon të vërë rend në një kaos të dukshëm dhe arrin ta bëjë këtë duke krijuar lloje qeverisjesh ose shoqërisë, duke numëruar përcaktues që ndikojnë mbi të gjitha bashkësitë dhe ndoshta, po ta shikojmë hollë-hollë, duke nxjerrë disa parime racionale me vlerë të përgjithshme, ndonëse ka raste kur ato shkelen. Monteskjë nisët nga diversiteti dhe arrin, jo pa u munduar, në njësinë njerëzore.

Përkundrazi, Ogyst Konti është, pikësëpari dhe mbi të gjitha, sociolog i njësisë njerëzore e shoqërore, i njësisë së historisë së njerëzimit. Ai e shtyn këtë kuptim të njësisë deri në pikën në të cilën, më në fund, vështirësia është e përkundërt: ai mundohet të gjejë dhe të themelojë diversitetin. Meqenëse ka vetëm një lloj shoqërie absolutisht të pranueshme, i gjithë njerëzimi duhet shpënë, sipas filozofisë së tij, drejt këtij lloji të shoqërisë.

Tri etapat e mendimit të Ogyst Kontit

Rrjedhimisht, më duket se etapat e zhvillimit filozofik të Ogyst Kontit mund të paraqiten sikur të përfaqësonin tri mënyrat, në të cilat është afirmuar, shpjeguar dhe justifikuar teza e njësisë shoqërore. Këto tri etapa shprehen përmes tri veprave kryesore të Ogyst Kontit.

E para, ndërmjet viteve 1820-1826, është ajo e *Broshurave për filozofinë shoqërore*: “Vlerësim i përmbledhur për gjithë të kaluarën moderne” (prill 1820), “Plani i punimeve shkencore të domosdoshme për organizimin e shoqërisë” (prill 1822), “Shqyrtime filozofike për shkencat dhe shkencëtarët”, (nëntor-dhjetor 1825), “Shqyrtime për pushtetin shpirtëror” (1825-1826).

Etapën e dytë e përbëjnë leksionet e “Kursit të filozofisë pozitiviste” (të botuara prej vitit 1830 deri më 1840) dhe etapën e tretë e përbëjnë “Sistemi i politikës pozitiviste” dhe “Traktati i sociologjisë që ndërton besimin e njerëzimit” (botuar prej vitit 1851 deri më 1854).

Në etapën e parë, në *Broshurat* (të ribotuara në fund të vëllimit IV të “Sistemit të politikës pozitiviste” nga vetë Ogyst Konti, që donte ta shprehte kështu njësinë e mendimit të vet) politekniku i ri reflekton për shoqërinë e kohës së tij. Shumica e sociologëve kanë si pikënisje

shpjegimin e epokës së cilës i përkasin. Ogyst Konti është në këtë pikëpamje shembull. *Broshurat* janë përshkrim dhe shpjegim i çastit historik nëpër të cilin kalon shoqëria evropiane në fillim të shek. XIX.

Sipas Ogyst Kontit, një lloj i caktuar i shoqërisë, i karakterizuar me cilësorët teknologjikë e militarë, është duke vdekur. Shoqërinë mesjetare e kishte çimentuar besimi transcendent i interpretuar nga Kisha katolike. Mënyra e të menduarit teologjik ishte bashkëkohëse e mbizotërimit të veprimtarisë ushtarake që shprehej nëpërmjet sërës së parë që u jepej luftëtarëve. Një lloj tjetër i shoqërisë, shkencore dhe industriale, është duke lindur. Shoqëria që po lind është shkencore në kuptimin në të cilin shoqëria që po vdes ishte teologjike: mënyra e të menduarit, karakteristikë e epokës moderne, është ajo e shkencëtarëve, ashtu sikur mënyra e të menduarit, karakteristikë e kohëve të shkuara, ishte ajo e teologëve ose priftërinjve. Shkencëtarët zëvendësojnë priftërinjtë dhe teologët, si kategori shoqërore që ushqen bazën intelektuale dhe morale të rendit shoqëror. Ata janë duke trashëguar prej priftërinjve pushtetin shpirtëror, i cili në *Broshurat* e para të Kontit, mishërohet, detyrimisht në çdo epokë, në ata që ofrojnë modelin e mënyrës mbizotëruese të të menduarit dhe idetë që i shërbejnë si parime rendit shoqëror. Ashtu si shkencëtarët që janë duke u zëvendësuar nga priftërinjtë, industrialistët, në kuptimin e gjerë të fjalës – domethënë ndërmarrësit, drejtuesit e fabrikave dhe bankierët – janë duke zënë vendin e luftëtarëve. Që nga momenti kur njerëzit mendojnë në mënyrë shkencore, veprimtaria madhore e bashkësive pushon së qeni luftë e njerëzve të një grupimi kundër tjetrit, por bëhet luftë e njerëzve kundër natyrës, ose edhe shfrytëzim racional i pasurive natyrore.

Që nga kjo epokë, Ogyst Konti nxjerr nga ky përimitim i shoqërisë në të cilën jeton përfundimin se reforma shoqërore ka si kusht themelor reformën intelektuale. Të papriturat e një revolucionit ose dhuna nuk lejojnë riorganizimin e shoqërisë në krizë. Për këtë arsye, duhet një sintezë shkencash dhe krijimi i një politike pozitivistë.

Ogyst Konti, si shumë bashkëkohës të tij, mendon se shoqëria është në krizë dhe shpjegimin e turbullirave shoqërore e sheh në kontradiktën ndërmjet një rendi shoqëror, teologjik e militar, që po zhdukej, dhe një rendi shoqëror, shkencor e industrial, që po lindte.

Ky interpretim i krizës bashkëkohore rrjedh nga shkaku që Ogyst Konti, si reformator, nuk është doktrinar i revolucionit në mënyrën e Marksit dhe as doktrinar i institucioneve të lira në mënyrën e Monteskjësë ose të Tokëvilit. Ai është doktrinar i shkencës pozitiviste dhe i shkencës shoqërore.

Orientimi i përgjithshëm i mendimit dhe sidomos i planeve të transformimit të Kontit rrjedh nga ky interpretim i shoqërisë bashkëkohore. Po ashtu siç e vëzhgonte Monteskjë krizën e monarkisë franceze dhe po ashtu siç ishte ky vëzhgim njëri nga burimet e kuptimit të tij të përgjithshëm, Ogyst Konti e vëzhgon kontradiktën e dy llojeve shoqërore që, si mendon ai, nuk mund të zgjidhet veçse nëpërmjet triumfit të llojit shoqëror, që e quan shkencor e industrial. Kjo fitore është e pashmangshme, por ajo mund të jetë pak a shumë e vonuar ose e përshpejtuar. Sociologjia, në të vërtetë, ka për detyrë ta kuptojë zhvillimin e nevojshëm, domethënë të domosdoshëm dhe të pashmangshëm njëherësh, të historisë, në mënyrë që të ndihmojë në përkryerjen e rendit themelor.

Në etapën e dytë, në atë të “Kursit të filozofisë pozitiviste”, idetë drejtuese nuk kanë ndryshuar, por perspektiva është zgjeruar. Në *Broshurat* e veta Ogyst Konti shqyrton kryesisht shoqëritë bashkëkohore dhe të kaluarën e tyre, domethënë historinë e Evropës. Do të ishte lehtë për një joevropian të vërë në dukje se Ogyst Konti në *Broshurat* e veta të para e kupton në mënyrë naive historinë e Evropës, si një histori që absorbon në vetvete historinë e njerëzimit ose, për më tepër, e paramendon karakterin shembullor të historisë evropiane, duke qenë se pranon që rendi shoqëror, drejt të cilit synon shoqëria evropiane, do të jetë rendi i gjithë njerëzimit. Gjatë etapës së dytë, domethënë në “Kursin e filozofisë pozitiviste”, Ogyst Konti nuk i përtërin këto tema, por i thellon ato dhe zbaton programin, vijat e trasha të të cilit i kishte përcaktuar në veprat e rinisë.

Ai bën rishikimin e shkencave të ndryshme dhe zhvillon e vërteton dy ligjet kryesore, që tanimë i kishte parashtruar në *Broshurat* e veta: ligjin e tri stadeve dhe klasifikimin e shkencave.¹

Sipas ligjit të tri stadeve, mendja njerëzore duhet të ketë kaluar nëpër tri faza të njëpasnjëshme. Në të parën, mendja njerëzore i shpjegon fenomenet, duke mos ua veshur ato qenieve ose forcave të

krahasueshme me vetë njeriun. Në të dytën, ai u referohet entiteteve abstrakte, siç është natyra. Në të tretën, njeriu mjaftohet me vëzhgimin e fenomeneve dhe caktimin e lidhjeve të rregullta që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre, qoftë në një moment të caktuar, qoftë në kohë. Ai heq dorë nga zbulimi i shkaqeve të fakteve dhe kënaqet me vendosjen e ligjeve që i drejtojnë ato.

Kalimi prej epokës teologjike në epokën metafizike, pastaj në epokën pozitiviste, nuk kryhet njëkohësisht për disiplinat e ndryshme intelektuale. Në mendimin e Ogyst Kontit, ligji i tri stadeve nuk ka kuptim të përpiktë, veçse i kombinuar me klasifikimin e shkencave. Rendi në të cilin janë radhitur shkencat e ndryshme na zbulon rendin në të cilin inteligjenca bëhet pozitiviste në fusha të ndryshme.²

Me fjalë të tjera, mënyra e të menduarit pozitivist është imponuar më parë në matematikë, në fizikë, në kimi, sesa në biologji. Për këtë arsye, është normale që pozitivizmi paraqitet më vonë në disiplinat që zbatohen në çështjet më të ndërlikuara. Sa më e thjeshtë të jetë çështja, aq më lehtë është të mendohet në mënyrën pozitiviste. Ka madje disa fenomene, ku vëzhgimi imponohet vetvetiu, në atë mënyrë që, në këto raste, inteligjenca ka qenë drejtpërdrejt pozitiviste.

Kombinimi i ligjit të tri stadeve dhe klasifikimi i shkencave ka si qëllim të provojë se mënyra e të menduarit, që ka triumfuar në matematikë, në astronomi, në fizikë, në kimi dhe në biologji, duhet të pranohet më në fund edhe në çështjet e politikës dhe të çojë në krijimin e një shkence të shoqërisë, që është sociologjia.

Mirëpo, ajo nuk synon vetëm të provojë nevojën e krijimit të sociologjisë. Duke filluar nga shkenca e biologjisë, në fushën e metodologjisë ndodh një përmbysje vendimtare: shkencat nuk janë me shkenca analitike, por, detyrimisht, kryesisht shkenca sintetike. Kjo përmbysje do të bëhet bazë e kuptimit sociologjik të njësisë historike.

Këta dy terma, analitik e sintetik, kanë në gjuhën e Ogyst Kontit kuptime të shumëfishta. Pikërisht në këtë shembull, shkencat e natyrës inorganike, fizika dhe kimia, janë analitike në kuptimin që ato vendosin ligje ndërmjet fenomeneve të veçuara dhe të veçuara detyrimisht e me të drejtë. Përkundrazi, në biologji është e pamundur të shpjegohet një organ ose një funksion në qoftë se nuk merret në

shqyrtim qenia e gjallë në tërësi. Pikërisht në lidhje me organizmin në tërësi, një fakt i veçantë biologjik merr kuptimin dhe gjen shpjegimin e vet. Në qoftë se do të donim të ndanim arbitrarisht e artificialisht një element nga një qenie e gjallë, para nesh do të kishim vetëm një materie të vdekur. Materia e gjallë, si e tillë, është e përgjithshme ose e plotë.

Kjo ide e përparësisë së tërësisë mbi elementin duhet të transponohet në sociologji. Është e pamundur të kuptohet gjendja e fenomenit të veçantë shoqëror në qoftë se ai nuk rivendoset në tërësinë shoqërore. Nuk kuptohet gjendja e besimit, ose forma e saktë që merr shteti në një shoqëri të veçantë, pa shqyrtimin e tërësisë së kësaj shoqërie. Por, kjo përparësi e tërësisë mbi elementin nuk vlen vetëm për një moment artificialisht të ndarë nga ndryshimi historik. Nuk kuptohet gjendja e shoqërisë franceze në fillimet e shek. XIX, pa rivendosjen e këtij momenti historik në vazhdimësinë e ndryshimit francez. Restaurimi kuptohet vetëm nëpërmjet Revolucionit, kurse Revolucioni nëpërmjet shekujve të regjimit monarkik. Tatëpjeta e frymës teologjike e militare shpjegohet vetëm nëse e gjejmë origjinën e saj në shoqërinë e së kaluarës. Ashtu siç nuk kuptohet një element i tërësisë shoqërore pa shqyrtimin e kësaj tërësie, po ashtu nuk kuptohet një moment i zhvillimit historik pa u shqyrtuar vetë tërësia e zhvillimit historik.

Mirëpo, duke vazhduar të mendojmë në këtë mënyrë, hasim një vështirësi të dukshme. Prandaj, për të kuptuar një moment të zhvillimit të kombit francez, do të duhej referuar tërësisë së historisë së njerëzimit. Logjika e parimit të përparësisë së tërësisë mbi elementin çon, më në fund, tek ideja se ajo që është parësore, ajo që është objekt i vërtetë i sociologjisë, është historia e racës njerëzore.

Ogyst Konti ishte njeri i logjikshëm, i formuar në degët shkencore të shkollës politeknike. Duke qenë se i kishte dhënë përparësi sintezës ndaj analizës, ai duhej të nxirrte si përfundim se shkencën shoqërore që kërkonte të themelonte kishte si objekt historinë e racës njerëzore; meqenëse e konsideronte si një të vetme, ajo ishte e domosdoshme për të kuptuar qoftë funksionet e veçanta të tërësisë shoqërore, qoftë një moment të veçantë të ndryshimit.

Në “Kursin e filozofisë pozitiviste” themelohet shkenca e re, sociologjia, e cila duke pranuar përparësinë e tërësisë ndaj elementit dhe të sintezës ndaj analizës, ka si objekt historinë e racës njerëzore.

Këtu shihet inferioriteti ose superioriteti – për mendimin tim inferioriteti – i Ogyst Kontit ndaj Monteskjësë. Ndërsa Monteskjë niset nga fakti , të cilin e përbën diversiteti, Ogyst Konti me atë logjikën e tepruar, që është tipar i njerëzve të mëdhenj dhe i disave më pak të mëdhenj, niset nga njësia e racës njerëzore dhe ia përcakton sociologjisë si objekt studimi historinë e racës njerëzore.

Duhet shtuar se Ogyst Konti, që konsideron se sociologjia është një shkencë si shkencat e tjera para saj, nuk ngurron të rimarrë formulën që kishte përdorur në *Broshurat* e tij: ashtu siç nuk ka liri të ndërgjegjes në matematikë ose në astronomi, nuk mund të ketë më tepër as në fushën e sociologjisë. Meqenëse shkencëtarët ua imponojnë verdiktin e tyre të paditurve dhe amatorëve në fushën e matematikës dhe të astronomisë, logjikisht ata duhet ta imponojnë verdiktin e tyre edhe në fushën e sociologjisë dhe të politikës. Kjo sigurisht parakupton që sociologjia mund të përcaktojë njëherësh ç’është, ç’do të jetë, dhe ç’duhet të jetë. Sociologjia sintetike e Ogyst Kontit frymëzon edhe një kompetencë të kësaj natyre. Si shkencë e tërësisë historike, ajo përcakton, në të vërtetë, jo vetëm ç’ka qenë e ç’është, por edhe ç’do të jetë në kuptimin e domosdoshmërisë së determinizmit. Se ç’do të jetë ajo, e përligj si të thuash përshtatja me atë që filozofët e së kaluarës mund ta kenë quajtur natyrë njerëzore, përshtatja me atë që Ogyst Konti e quan thjesht realizim të rendit njerëzor e shoqëror. Në etapën e tretë të mendimit të tij, ai arrin ta përligjë këtë njësi të historisë njerëzore nëpërmjet një teorie njëherësh të natyrës njerëzore dhe të asaj shoqërore.

“Sistemi i politikës pozitiviste” vjen pas aventurës së autorit të tij me Klotildë dë Vo. Stili dhe gjuha kanë pësuar pak ndryshime në krahasim me “Kursin e filozofisë pozitiviste”. Por, nuk është më pak e vërtetë që “Sistemi i politikës pozitiviste” i përgjigjet një prirjeje të dukshme të mendimit kontist në etapën e parë dhe sidomos në etapën e dytë.

Në të vërtetë, në qoftë se, si mendoj unë, udha e Ogyst Kontit mund të shpjegohet me vullnetin për të përligjur idenë e njësisë së

historisë së njerëzimit, është normale që në librin e tij të fundit t'i ketë vënë një bazë filozofike këtij nocioni. Që historia e njerëzimit të jetë një, njeriu duhet të ketë në të gjitha shoqëritë, në të gjitha epokat, një natyrë të caktuar të arsyeshme dhe të pakufizueshme. Së dyti, çdo shoqëri duhet të përmbajë një rend thelbësor, që mund të njihet nëpërmjet diversitetit të organizimeve shoqërore. Më në fund, që kjo natyrë njerëzore dhe kjo natyrë shoqërore të jetë e atillë, duhet që karakteristikat e rëndësishme të zhvillimit historik të nxirren prej vetë saj. Pra, sipas mendimit tim, thelbi i "Sistemit të politikës pozitiviste" mund të shpjegohet me anën e këtyre tri ideve.

Teoria e natyrës njerëzore gjendet e përfshirë në atë që Ogyst Konti e quan pasqyrë trunore, tërësi e kuptimeve që lidhen me lokalizimet trunore. Por, pa marrë parasysh këtë apo atë tuhafësi, kjo pasqyrë trunore është baras me saktësimin e aktiviteteve të ndryshme karakteristike të njeriut si njeri. Rendi shoqëror themelor, që mund të njihet nëpërmjet diversitetit të institucioneve, është përshkruar e përimtuar në vëll. II, i cili ka si objekt "Statikën shoqërore". Më në fund, pasqyra trunore dhe statika shoqërore shërbejnë si bazë e vëll. III, të "Sistemit të politikës pozitiviste" që i kushtohet dinamikës. Gjithë historia synon realizimin e rendit themelor të çdo shoqërie, të përimtuar në vëll. II, dhe përmbushjen e më së mirës që ka në natyrën njerëzore, të përshkruar në pasqyrën trunore të vëll. I.

Pikënisja e mendimit të Ogyst Kontit është, pra, një reflektim për kontradiktën e brendshme të shoqërisë së kohës së tij, midis llojit teologjik e militar dhe llojit shkencor e industrial. Duke qenë se këtë moment historik e karakterizon përgjithësimi i mendimit shkencor dhe i veprimtarisë industriale, mënyra e vetme për t'i dhënë fund krizës është të përshpejtohet ndryshimi duke krijuar sistemin e ideve shkencore, që do të zotëronte në mendimin shoqëror, ashtu siç ka zotëruar në rendin shoqëror të së kaluarës sistemi i ideve teologjike. Së këtejmi Ogyst Konti kalon në "Kursin e filozofisë pozitiviste", domethënë në sintezën e tërësisë së veprës shkencore të njerëzimit, me qëllim që t'i nxjerrë metodat, që janë zbatuar në disiplinat e ndryshme dhe rezultatet thelbësore, të cilat janë arritur në secilën prej tyre. Kjo sintezë e metodave dhe e rezultateve duhet të shërbejë si bazë për krijimin e sociologjisë si shkencë, që ende mungon.

Mirëpo, sociologjia që kërkon të krijojë Konti nuk është sociologji e matur, modeste e analitike e Monteskjësë, e cila përpiqet t'i shumëfishojë shpjegimet për të kuptuar skajshmërinë e diversitetit të institucioneve njerëzore. Puna e saj është të zgjidhë krizën e botës moderne, domethënë të japë sistemin e ideve shkencore që do të zotërojnë në organizimin shoqëror. Por, që një shkencë të mund të përmbushë një rol të tillë, ajo duhet të japë rezultate që nuk lënë vend për të dyshuar dhe të sjellë të vërteta po aq të pakontestueshme sa matematika dhe astronomia. Gjithashtu, natyra e këtyre të vërtetave duhet të jetë e një lloji të caktuar. Sociologjia analitike e Monteskjësë sugjeron, aty-këtu, këtë apo atë reformë; ajo i jep këshilla ligjvënësit. Mirëpo, meqenëse niset nga ideja se institucionet e çfarëdo shoqërie qoftë kushtëzohen nga një shumësi faktorësh, ajo nuk lejon të imagjinohet një realitet institucional shumë i ndryshëm nga ai që ekziston. Ogyst Konti, nga ana e tij, kërkon të jetë njëkohësisht shkencëtar dhe reformator. Cila është, andaj, shkencë që mund të jetë njëherësh e sigurt në pohimet e veta dhe urdhëruese për një reformator? Pa pikë dyshimi, ajo do të ishte një shkencë sintetike, siç e kupton Ogyst Konti, shkencë që do të nisej nga ligjet më të përgjithshme, nga ligjet themelore të zhvillimit njerëzor dhe do të zbulonte një determinizëm global, që njerëzit do të mund ta përdornin në njëfarë mënyre. Sipas shprehjes pozitiviste, një "fatalitet i ndryshueshëm".

Sociologjia e Ogyst Kontit fillon nga ajo që është më interesante për t'u ditur. Për sa u përket hollësive, ajo ua lë ato historianëve, domethënë, sipas autorit tonë, zelltarëve të errët, të zhytur në një erudicion mediokër, që i përbuz ai i cili ka kuptuar menjëherë ligjin më të përgjithshëm të zhvillimit.

Monteskje e Tokëvil i japin njëfarë përparësie të caktuar politikës ose formës së shtetit, ndërsa Marksi organizimit ekonomik. Doktrina e Ogyst Kontit bazohet mbi idenë se çdo shoqëri qëndron nga mirëkuptimi i njerëzve.³ Ka shoqëri vetëm aq sa ka anëtarë besimesh të njëjta. Kjo është mënyra e të menduarit që karakterizon etapat e ndryshme të njerëzimit, kurse në etapën aktuale dhe të fundit do të lërë gjurmë përgjithësimi triumfal i mendimit pozitivist.

Pasi kishte ndjekur kështu, deri në fund, pikëpamjen për një histori të njësishtme njerëzore, Ogyst Konti detyrohet ta themelojë këtë njësi dhe nuk mund ta themelojë atë me terma filozofike, veçse duke iu referuar një pikëpamjeje për natyrën e përhershme njerëzore dhe për rendin shoqëror themelor, gjithashtu të përhershëm.

Filozofia e Ogyst Kontit nënkupton, pra, tri tema të mëdha.

E para është shoqëria industriale, sepse kjo, shoqëria e Evropës Perëndimore, ka karakter shembullor dhe do të bëhet shoqëria e gjithë njerëzimit. Nuk është vërtetuar që Ogyst Konti të mos ketë pasur të drejtë, duke menduar se disa aspekte të shoqërisë industriale të Evropës kishin një prirje të gjithanshme. Organizimi shkencor i punës, karakteristikë e shoqërisë evropiane, është aq shumë i frytshëm se të gjitha organizimet e tjera, sa që me të zbuluar të kësaj fshehtësie nga një popull, të gjitha pjesët e tjera të njerëzimit duhen ta shtënë në dorë, sepse ai është kushti i prosperitetit dhe i fuqisë.

E dyta është gjithanshmëria e dyfishtë e mendimit shkencor. Mendimi pozitivist në matematikë, në fizikë ose në biologji, ka një prirje të përgjithshme në kuptimin që të gjitha pjesët e njerëzimit e përvetësojnë këtë mënyrë të menduari, pasi të jenë bërë të dukshme të gjitha sukseset e arritura në saje të saj. Ogyst Konti kishte të drejtë në këtë pikë; shkencat perëndimore është bërë sot shkencë e gjithë njerëzimit, qoftë kur bëhet fjalë për matematikën, për astronominë, për fizikën, për kiminë, madje, në një masë shumë të gjerë, edhe për biologjinë. Mirëpo, gjithanshmëria e shkencës ka një kuptim tjetër. Meqenëse mendojmë me përpikëri në fushë të astronomisë ose të fizikës, nuk mund të mendojmë ndryshe në fushën e politikës ose të fesë. Metoda pozitiviste që korr suksese në shkencat e natyrës inorganike, duhet të shtrihet në të gjitha aspektet e mendimit. Ja që ky përgjithësim i metodës pozitiviste është fare i dukshëm. A jemi të dënuar ta riprodhojmë metodën e matematikës ose të fizikës në sociologji, në moral ose në politikë? Të paktën debati është ende i hapur.

Tema e tretë themelore e Ogyst Kontit është tema e "Sistemit të politikës pozitiviste". Në qoftë se natyra njerëzore është rrënjësisht e njëjtë, në qoftë se rendi shoqëror është rrënjësisht i njëjtë, si të shpëtohet, po të gjykojmë hollë, diversiteti?

Me fjalë të tjera, mendimi i Ogyst Kontit për njësinë njerëzore merr tri forma, në tri etapat kryesore të karrierës së tij:

Shoqëria që po zhvillohet në Perëndim është shembullore; gjithë njerëzimi do të hyjë në rrugën që po ndjek avangarda perëndimore.

Historia e njerëzimit është histori e mendjes, si zhvillim i mendimit pozitivist, ose të paktën mësim i pozitivizmit nga i gjithë njerëzimi.

Historia e njerëzimit është zhvillim dhe lulëzim i natyrës njerëzore.

Këto tri tema, aspak kontradiktore, janë, në njëfarë mënyre, të pranishme në secilën nga etapat e veprimtarisë së Ogyst Kontit, por të theksuara në mënyrë të pabarabartë. Ato përfaqësojnë tri interpretime të mundshme të temës për njësinë e njerëzimit.

Shoqëria industriale

Idetë drejtuese të Ogyst Kontit gjatë viteve të rinisë nuk janë të tijat. Bindjen se mendimi teologjik i përkiste së kaluarës e ka vjelë në mjedisin e epokës; se Zoti kishte vdekur, për të përdorur formulimin e Niçes; se mendimi shkencor drejtonte këtej e tutje inteligjencën e njerëzve të kohës; se me teologjinë struktura feudale ose organizimi monarkik ishte në zhdukje e sipër; se shkencëtarët dhe industrialistët do të zotëronin shoqërinë e kohës sonë.

Të gjitha këto tema janë të zhveshura nga origjinaliteti, por, ajo që ka rëndësi të kuptohet, është zgjedhja që bën Ogyst Konti midis temave të zakonshme të kohës për ta përkufizuar interpretimin e tij të shoqërisë bashkëkohore.

Fakti i ri që u bie në sy gjithë vëzhguesve të shoqërisë së fillimit të shek. XIX është industria. Të gjithë janë të mendimit se po lind diçka origjinale në krahasim me të kaluarën. Por, me çka ka të bëjë ky origjinalitet i industrisë së kohës?

Më duket se tiparet karakteristike të industrisë, ashtu siç i vështrojnë njerëzit e fillimit të shek. XIX, janë gjashtë:

1. Industria bazohet mbi organizmin shkencor të punës. Në vend që të organizohet sipas zakonit, prodhimi ftillohet për të arritur rendiment më të madh.
2. Në saje të zbatimit të shkencës në organizimin e punës, njerëzimi zhvillon për mrekulli resurset e veta.

3. Prodhimi industrial nënkupton përqendrimin e punëtorëve në fabrika dhe në lagjet e jashtme; paraqitet një fenomen shoqëror: ekzistimi i masave punonjëse.

4. Këto përqendrime në vendin e punës nxisin një kundërshti latente ose të hapur ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve, ndërmjet proletarëve dhe ndërmarrësve ose kapitalistëve.

5. Kur pasuria rritet pareshtur, falë karakterit shkencor të punës, shumohen krizat e mbiprodhimit, të cilat kanë për pasojë krijimin e varfërisë në mesin e bollëkut. Për çudi, kur me miliona njerëz vuajnë nga varfëria, mallrat nuk arrijnë të shiten.

6. Sistemi ekonomik i lidhur me organizmin industrial e shkencor të punës karakterizohet me lirinë e këmbimeve dhe me kërkimin e profitit nga ndërmarrësit e tregtarët. Disa teoricienë nxjerrin nga kjo përfundimin se kushti thelbësor i zhvillimit të pasurive është pikërisht kërkimi i profitit dhe konkurrenca dhe se, sa më pak të përzihet shteti në punët ekonomike, aq më shpejt do të rriten prodhimi e pasuritë.

Interpretimet ndryshojnë sipas pjesëmarrjes së secilës prej këtyre veçorive. Sa i përket Ogyst Kontit, ai i quan vendimtare tri të parat. Industrinë e përcakton organizimi shkencor i punës, prej të cilit rrjedh rritja e vazhdueshme e pasurive dhe përqendrimi i punëtorëve në fabrika; ky i fundit, përveç kësaj, ka edhe anën e vet të mirë, sepse përqendron kapitalet ose mjetet e prodhimit në duar të një numri të vogël njerëzish.

Veçoria e katërt, kundërshtia ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve, është dytësore⁴ për të. Ajo është rrjedhim i një organizimi të keq të shoqërisë industriale dhe mund të korrigjohet me reforma. Gjithashtu, në sytë e tij, krizat janë fenomene episodike dhe sipërfaqësore. Për sa i përket liberalizmit, ai e sheh atë jo si thelb të shoqërisë së re, por si element patologjik, element krize në zhvillimin e një organizimi, i cili do të jetë shumë më tepër i qëndrueshëm nëse bazohet mbi lojën e lirë të konkurrencës.

Natyrisht, sipas socialistëve, dy veçoritë vendimtare janë e katërta dhe e pesta. Mendimi socialist, si ai i ekonomistëve pesimistë të gjysmës së parë të shek. XIX, zhvillohet duke u nisur nga konstatimi i konfliktit proletar-ndërmarrës dhe nga denduria e krizave të konsideruara si vazhdim i pashmangshëm i anarkisë kapitaliste.

Pikërisht duke u nisur nga këto dy veçori, Marksii ndërton teorinë e tij të kapitalizmit dhe interpretimin historik.

Për sa i përket veçorisë së gjashtë, lirisë së këmbimeve, teoricienët liberalë vënë në dukje pikërisht atë dhe e konsiderojnë si shkakun vendimtar të përparimit ekonomik.

Në fillim të shek. XIX të gjithë vinin re njëkohësisht rritjen e pasurive, zbatimin e shkencës në industri dhe një regjim liberal të këmbimeve. Interpretimet ndryshonin sipas përgjegjësisë që i vishej secilit prej këtyre dy fenomeneve në zhvillimin e të parit.

Ogyst Konti bën përkufizimin e vet të teorisë së shoqërisë industriale duke kundërshtuar qoftë ekonomistët liberalë, qoftë socialistët. Versioni i tij për shoqërinë industriale s'është as liberal, as socialist, por ai do të mund të përkufizohej si teori e organizimit, po të mos ishte përdorur kjo fjalë për përkthimin francez të veprës së Burnhamit, *The Managerial Revolution*,⁵ sepse organizatorët e Ogyst Kontit dallojnë mjaft nga "menagers" të Burnhamit.

Ogyst Konti qorton ekonomistët liberalë, të cilët merren me vlerën dhe përpiqen të përcaktojnë në mënyrë abstrakte funksionimin e sistemit, sepse janë metafizikanë. Sipas tij, mendimi metafizik është mendim abstrakt, mendim me anë konceptesh dhe i tillë është mendimi i ekonomistëve të kohës së tij.⁶

Nga ana tjetër, këta metafizikanë bëjnë gabim që i shohin fenomenet ekonomike si të ndara nga tërësia shoqërore. Ekonomia politike fillon me një veçim të jashtëligjshëm të një sektori të tërësisë, i cili nuk mund të kuptohet me përpikëri veçse brenda kësaj tërësie.

Këto dy kritika u rimorën nga shumica e sociologëve francezë të shkollës së Durkajmit dhe përcaktuan qëndrimin gjysmë të përkundërt të atyre që quhen sociologë kundrejt atyre që quhen ekonomistë, të paktën në universitetet franceze.

Në fund, Ogyst Konti qorton liberalët që mbivlerësojnë efektshmërinë e mekanizmave të këmbimit ose të garës në rritjen e pasurive.

Megjithatë, ekonomistët kanë meritën që pohojnë se me kalimin e kohës interesat private bien në ujdi. Në qoftë se kundërshtia thelbësore ndërmjet liberalëve dhe socialistëve rrjedh nga shkakun se të parët i besojnë ujdisë përfundimtare të interesave dhe të dytët i

besojnë karakterit themelor të luftës së klasave, Ogyst Konti është, për sa i përket kësaj çështje thelbësore, në anën e liberalëve. Ai nuk beson se ka kundërshti thelbësore interesash ndërmjet proletarëve dhe ndërmarrësve. Mund të ketë, në mënyrë të përkohshme dhe dytësore, rivalitete për ndarjen e pasurive. Mirëpo, Ogyst Konti mendon, sikur ekonomistët liberalë, se zhvillimi i prodhimit përputhet, parimisht, me interesat e të gjithëve. Ligj i shoqërisë industriale është rritja e pasurive, që vë si parim ose nënkupton ujdinë përfundimtare të interesave.

Në krahasim me ekonomistët, të cilët lirinë dhe konkurrencën i marrin si shkaqe thelbësore të rritjes, themeluesi i pozitivizmit i përket shkollës së atyre që do t'i quaja politeknike organizues.

Dy ekonomistë janë sot përfaqësuesit e dy prirjeve të frymës politeknike. Moris Ale përfaqëson prirjen e parë, që i beson rëndësisë vendimtare të mekanizmave konkurrues të rregullimit ekonomik.⁷ Një politeknik tjetër, Alfred Sovi, shumë më pak i dhënë pas mekanizmave të tregut sesa Moris Ale ose Zhak Ryef, përfaqëson një prirje tjetër, që i beson efektshmërisë mbizotëruese të organizimit.⁸ Ogyst Konti mund të konsiderohet si padron i shkollës organizuese.

Ky politeknik organizues është kundër socializmit ose, më saktësisht, kundër atyre që i quan komunistë, domethënë doktrinarë ose teoricienë të kohës së tij, kundërshtarë të pronës private. Ai është organizator që u beson jo aq shumë fuqive të konkurrencës, sa të pronës private, madje, ç'është më e çuditshme, organizator që u beson fuqive të pronës private të pasurive të përqendruara.

Ogyst Konti përlij me të vërtetë përqendrimin e kapitaleve dhe të mjeteve të prodhimit, që nuk i duket në kundërshtim me pronën private. Ai është, para së gjithash, i pashmangshëm, pohon ai, domethënë se ai është edhe i dobishëm, sipas këtij optimizmi providencial kaq karakteristik për filozofinë e tij të historisë. Ai është i ngjashëm me prirjen themelore që vërehet gjatë historisë së njerëzimit. Kultura materiale mund të rritet vetëm nëse çdo brez prodhon më tepër se ka nevojë për të jetuar dhe ia përkalon pastaj brezit tjetër një stok më të madh pasurie se ai që ka trashëguar. Kapitalizimi i mjeteve të prodhimit është veçori e zhvillimit të kulturës materiale dhe e nxit përqendrimin.

Ogyst Konti nuk është i ndjeshëm ndaj argumentit, sipas të cilit rëndësia e kapitaleve të përqendruara do të duhej të nxiste karakterin publik të pronës. Ai nuk nxjerr përfundimin se përqendrimi i mjeteve të prodhimit çon në nacionalizëm të domosdoshëm. Përkundrazi, ai është mjaft indiferent ndaj kundërshtisë midis pronës private dhe pronës publike, sepse konsideron se pushteti, qoftë ai ekonomik ose politik, është gjithnjë personal. Në çdo shoqëri njerëzit që drejtojnë janë pakicë. Njëra nga arsyet e kërkesës së pronës publike, e vetëdijshme ose e pavetëdijshme, është besimi me bazë të shëndoshë ose jo se zëvendësimi i një regjimi të pronës me një tjetër do ta ndryshonte strukturën e drejtimit shoqëror. Ogyst Konti është skeptik në këtë pikë. Janë gjithnjë të pasurit ata që mbajnë një pjesë të fuqisë, e cila nuk mund të mos e shoqërojë pasurinë dhe e cila është e pashmangshme në çdo rend shoqëror. Kudo ka njerëz që drejtojnë dhe është mirë që njerëzit i mbajnë këto kapitale të përqendruara, që e ushtrojnë autoritetin ekonomik e shoqëror të domosdoshëm.

Mirëpo, kësaj prone personale duhet t'i hiqet karakteri i saj arbitrarisht personal, meqenëse ata që i quan patricë, shefa të përkohshëm industrialë, bankarë, duhet ta kuptojnë rolin e tyre si një funksion shoqëror. Prona private është e nevojshme, e pashmangshme dhe e domosdoshme; por, ajo është e tolerueshme vetëm kur kuptohet, jo më si e drejtë për ta përdorur e abuzuar, por si ushtrim i një funksioni kolektiv nga ana e disave që fati ose merita i ka zgjedhur.⁹

Ogyst Konti, pra, merr një qëndrim të ndërmjetëm mes liberalizmit dhe socializmit. Ai nuk është doktrinar i pronës private të kuptuar në mënyrën e së drejtës romake. Ai nuk është reformator i prirë nga shoqërizimi i mjeteve të prodhimit. Ai është organizator që kërkon njëkohësisht ta ruajë pronën private dhe t'ia shndërrojë kuptimin duke e vënë në shërbim të ndonjë individi me funksion shoqëror. Ky konceptim nuk është larg nga disa doktrina të katolicizmit shoqëror.

Përtej kësaj teorie të pronës private, Ogyst Konti shton një ide tjetër që fiton rëndësi sidomos në librat e tij të fundit, "Sistemi i politikës pozitiviste", ide e karakterit të dorës së dytë të hierarkisë së përkohshme.

Doktrinari i pozitivizmit është i prirë ta pranojë përqendrimin e pasurive dhe autoritetin e industrialistëve sa më shumë që përvojën e njerëzve nuk e përkufizon ekskluzivisht vendi që ata zënë në hierarkinë ekonomike e shoqërore. Përveç rendit material që drejton ligji i fuqisë, ka një rend shpirtëror, ai i meritave morale. Punëtori që ndodhet në fund të hierarkisë materiale mund të jetë në shkallën më të lartë të hierarkisë shpirtërore, në qoftë se meritat e tij dhe përkushtimi ndaj kolektivit i kapërcejnë ato të udhëheqësve të tij hierarkikë.

Ky rend shpirtëror nuk është rend transcendent, i atillë çfarë ka mundur ta krijonte religjioni i krishterë. Ky nuk është rend i jetës së amshueshme. Ky është rend i kësaj bote, por që zëvendëson rendin e hierarkisë materiale të fuqisë dhe të pasurisë me rendin shpirtëror të meritave morale. Të jesh i pari jo në rendin e pushtetit, por në rendin e meritave, duhet të jetë qëllimi më i lartë i secilit.

Ogyst Konti i kufizon ambiciet e veta të reformës ekonomike, sepse shoqëria industriale nuk mund të ekzistojë në mënyrë të qëndrueshme, veçse me kusht që të rregullojë, të moderojë dhe të transfigurojë një pushtet shpirtëror. Dhe, vetëm aq sa qëllimi i tij reformator është qëndëruar drejt pushtetit shpirtëror, po aq duket i moderuar si reformator i ekonomisë.

Ky interpretim i shoqërisë industriale nuk ka luajtur pothuajse kurrfarë roli në zhvillimin e doktrinave ekonomike e shoqërore, të paktën në Evropë. Koncepti kontist i shoqërisë industriale ka mbetur një lloj kurioziteti, larg rivalitetit të doktrinave. Asnjë nga partitë politikë, as e djathta, as e majta, nuk e ka gjetur veten tek ajo, përveç disa individëve, disa prej të cilëve i përkitnin së djathtës ekstreme, ndërsa të tjerët së majtës.

Megjithatë, në mesin e autorëve francezë të shekullit njëzetë janë dy veta që e kanë përkrahur Ogyst Kontin. Njëri ishte Charl Moras, teoricien i monarkisë, ndërsa tjetri Alen, teoricien i radikalizmit. Si njëri ashtu dhe tjetri deklaroheshin pozitivistë, për arsye të ndryshme. Morasi ishte pozitivist, sepse e shikonte Ogyst Kontin si doktrinar të organizmit, të autoritetit dhe të një pushteti shpirtëror të përtërirë.¹⁰ Aleni ishte pozitivist, sepse e interpretonte Ogyst Kontin në dritën e Kantit dhe sepse, sipas tij, ideja thelbësore e pozitivizmit ishte të

zhvlerësonte hierarkinë shpirtërore. “Le të bëhet mbret ndihmëskuzhinieri më i mirë, por të mos provojë të na bëjë ta puthim tenxheren”.¹¹

Dhe, Konti i ka të dyja këto aspekte: pranon një rend material, autoritar e hierarkik dhe mbivendos mbi hierarkinë materiale një rend shpirtëror. Ogyst Konti nuk e pranonte filozofinë e Hobsit në rendin material, domethënë filozofinë e forcës, veçse për t’ia shtuar asaj filozofinë e Kantit. Vetëm shpirti është i respektueshëm, vetëm vlera morale është e respektueshme. Kështu shkruante Aleni: “Rendi nuk është kurrë i nderuar”.

Përse koncepti i Ogyst Kontit ka ngelur jashtë rrjedhës së madhe të filozofisë së shoqërisë moderne? Kjo pyetje meriton të shtrohet. Në njëfarë kuptimi, doktrina e Ogyst Kontit është sot më afër doktrinave që janë në modë sesa shumë doktrina të tjera të shek. XIX. Të gjitha teoritë që aktualisht vënë theksin mbi ngjashmërinë e një numri të madh institucionesh nga njëra dhe ana tjetër e perdes së hekurt, zhvlerësojnë rëndësinë e mekanizmave të konkurrencës dhe synojnë t’i nxjerrin tiparet themelore të qytetërimit industrial, do të mund të mburreshin me Ogyst Kontin. Ai është teoricien i shoqërisë industriale, përtej ose larg zënkave ndërmjet liberalëve dhe socialistëve, ndërmjet doktrinarëve të tregut dhe apologetëve të planit.

Temat kontiste themelore për punën e lirë, zbatimin e shkencës në industri dhe mbizotërimin e organizimit, janë mjaft karakteristike për kuptimin aktual të shoqërisë industriale. Përse Ogyst Konti është harruar ose nuk çmohet sa duhet?

Arsyeja e parë është që, nëse idetë madhore të pozitivizmit janë të thella, përshkrimi i hollësishëm që i bën shoqërisë industriale, veçanërisht në “Sistemin e politikës pozitiviste”, i lë shteg shpesh ironizimit të lehtë. Konti ka dashur të shpjegonte hollësisht se si do të organizohej hierarkia materiale, cili do të ishte vendi i saktë i drejtuesve materialë, industrialë dhe bankarë. Ai ka dashur të tregonte përse ata që ushtrojnë funksionet më të përgjithshme do ta kishin autoritetin më të lartë dhe do ta kishin vendin më të lartë në hierarki. Ai ka dashur të saktësonte numrin e burrave të çdo qyteti, numrin e patricëve. Ai ka dashur të shpjegonte se si do të

transmetoheshin pasuritë. Shkurt, ai ka bërë një plan të saktë të ëndrrave të tij ose të ëndrrave, të cilave mund t'u dorëzohet secili prej nesh, në çastet kur e konsideron veten Zot.

Nga ana tjetër, koncepti i Ogyst Kontit për shoqërinë industriale lidhet me pohimin se luftërat janë bërë anakronike.¹² Mirëpo, nuk mund të vihet në dyshim se ndërmjet viteve 1840 dhe 1945 historia nuk ka qenë e përpiktë në takim. Gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli pati shumë luftëra jashtëzakonisht të egra, të cilat zhgënjyen dishepujt besnikë të shkollës pozitiviste.¹³ Kjo urdhëronte me dekret që luftërat të zhdukeshin nga avangarda e njerëzimit, domethënë nga Evropa Perëndimore. Pikërisht Evropa Perëndimore ka qenë qendra dhe vatra e luftërave të shek. XX.

Sipas Ogyst Kontit, pakica perëndimore që ishte, fatmirësisht, në krye të lëvizjes së njerëzimit, nuk duhej t'i pushtonte popujt e tjerë për t'iu imponuar qytetërimin. Ai kishte shpjeguar me argumente të shkëlqyeshme, dua të them me argumente që atij i dukeshin të shkëlqyeshme dhe që neve na duken të shkëlqyeshme falë urtësisë që fituam nga ngjarjet, se perëndimorët nuk duhej të pushtonin Afrikën e Azinë dhe se, në qoftë se do të gabonin ta përhapnin qytetërimin e tyre me forcën e bajonetës, do të rridhnin fatkeqësi si për ata, ashtu edhe për të tjerët. Këtu ka pasur të drejtë, megjithëse ai gjithmonë gabon. Ngjarjet e një shekulli të tërë nuk janë përputhur me parashikimet e tij.¹⁴

Ogyst Konti është bërë profet i paqes, sepse gjykonte se lufta nuk luante më rol në shoqërinë industriale. Lufta ishte e nevojshme për t'i detyruar njerëzit përtacë e anarkikë të punonin rregullisht, për të krijuar shtete të gjera, me qëllim që të shfaqej njësia e Perandorisë Romake, në të cilën do të përhapej krishterimi dhe prej të cilit do të dilte, më në fund, pozitivizmi. Lufta kishte përmbushur një funksion të dyfishtë historik: i kishte mësuar njerëzit të punonin dhe kishte formuar shtete të mëdha. Mirëpo, në shek. XX ajo nuk kishte më rol për të luajtur. Shoqëritë ishin përkufizuar këtej e tutje nëpërmjet përparësisë së punës dhe vlerave të saj. Nuk kishte më klasë ushtarake, as arsye për të luftuar.¹⁵

Pushtimet kanë mundur të ishin në të kaluarën një mjet legjitim ose të paktën racional për ata që nxirrnin fitime prej tyre, për t'i shtuar

resurset. Në shekullin në të cilin pasuria varet nga organizimi shkencor i punës, preja nuk ka më kuptim dhe është anakronike. Përkalimi i të mirave bëhet që këtej e tutje nëpërmjet dhurimit e këmbimit dhe, sipas Ogyst Kontit, dhurimi duhet të luajë një rol gjithnjë e më të madh, madje ta reduktojë në njëfarë mase atë të këmbimit.¹⁶

Më në fund, filozofia e Ogyst Kontit nuk e kishte vënë në qendër interpretimin e shoqërisë industriale. Ajo synonte sidomos reformimin e organizimit material nëpërmjet pushtetit shpirtëror, që duhej të ishte çështje e shkencëtarëve dhe e filozofëve, si zëvendësim i priftërinjve. Pushteti shpirtëror duhej të merrej me ndjenjat e njerëzve, t'i bashkonte me qëllim të një pune të përbashkët, t'u kushtohej të drejtave të atyre që qeverisnin, të zbuste arbitraritetin ose egoizmin e të fuqishmëve. Shoqëria e ëndërruar nga pozitivizmi nuk është aq e përkufizuar nëpërmjet refuzimit të dyfishtë të liberalizmit dhe të socializmit, sa nëpërmjet krijimit të një pushteti shpirtëror që do të ishte në kohën e pozitivizmit, siç ishin priftërinjtë dhe kishat në kohërat teologjike të së kaluarës.

Mirëpo, pikërisht në këtë çështje historia i ka zhgënjyer me gjasë dishepujt e Ogyst Kontit. Madje, edhe nëse organizimi material i shoqërisë industriale i ngjasonte asaj që imagjinonte Ogyst Konti, pushteti shpirtëror i filozofëve dhe dijetarëve nuk kishte lindur ende. Pushteti shpirtëror ekzistues është ushtruar qoftë nga kisha e së kaluarës, qoftë nga ideologët, të cilët ai vetë nuk do t'i kishte pranuar si dijetarë ose filozofë të njëmendtë.

Në masën e në të cilën njerëzit që pretendojnë të jenë interpretues shkencorë të rendit shoqëror, ushtrojnë pushtet shpirtëror, për shembull në Bashkimin Sovjetik, ata e vënë theksin jo mbi tiparet e përbashkëta të të gjitha shoqërive industriale, por mbi një doktrinë të veçantë organizimi të shoqërive industriale. As njëra palë as pala tjetër nuk e quan si patron atë që i ka zhvlerësuar konfliktet ideologjike, prej të cilave kanë jetuar shoqëritë evropiane dhe prej të cilave kanë vdekur miliona njerëz.

Ogyst Konti mund të ketë dashur një pushtet shpirtëror të ushtruar nga interpretuesit e organizimit shoqëror, i cili do ta kishte zvogëluar njëkohësisht rëndësinë shoqërore të hierarkisë materiale. Ky lloj

pushteti shpirtëror nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston. Me gjasë, njerëzit parapëlqejnë gjithmonë atë që i ndan kundrejt asaj që i bashkon. Gjithashtu, me gjasë, shoqëritë ende nuk janë bindur sa duhet për virtytet që Ogyst Konti ia njihte shoqërisë industriale.

Ai mendonte në të vërtetë se organizimi shkencor i shoqërisë industriale do të arrinte t'i jepte secilit një vend në përpjesëtim me aftësitë e tij dhe kështu do ta realizonte drejtësinë shoqërore. Kishte shumë optimizëm në këtë vështrim. Në të kaluarën, moshë ose prejardhja u kishin dhënë njerëzve vendin e parë, tani e tutje, në shoqërinë e punës ishte aftësia që gjithnjë e më tepër do ta përcaktonte vendin e secilit.

Një sociolog anglez, Mikael Jung, i ka kushtuar një libër satirik një regjimi të quajtur meritokraci, domethënë idesë që, në fakt, Ogyst Konti e krijonte me një entuziazëm të parakohshëm për rendin e shoqërisë industriale.¹⁷ Ky autor nuk e citon Ogyst Kontin, ndërsa ky i fundit nuk do t'i kishte njohur shpresat e veta në përshkrimin e një rendi të tillë. Mikael Jung tregon, në të vërtetë me humor, se nëse secili zë një vend sipas përpjesëtimeve të kapacitetit të vet, ata që zënë vendet e poshtme janë të dëshpëruar, sepse nuk mund më ta akuzojnë fatin ose padrejtësinë. Në qoftë se të gjithë njerëzit janë të bindur se rendi shoqëror është i drejtë, për disa ky do të jetë disi i padurueshëm, në mos qofshin bindur nga mësimet e Ogyst Kontit se hierarkia e cilësive intelektuale s'është gjë përballë së vetmes hierarki të rëndësishme, asaj të meritave dhe të zemrës. Mirëpo, nuk është lehtë t'i bindësh njerëzit se rendi material është dytësor.

Sociologjia - shkencë e njerëzimit

Ogyst Konti e ka shprehur kuptimin e tij për shkencën e re të quajtur sociologji në tri vëllimet e fundit të "Kursit të filozofisë pozitiviste" dhe, në veçanti, në vëllimin IV. Ai u referohet tre autorëve, Monteskjësë, Kondersesë dhe Bosyesë, të cilët i paraqet si frymëzues dhe pararendës, pa numëruar Aristotelin, për të cilin do të flas më poshtë. Këta tre emra fusin në mendimin e tij sociologjik disa prej temave themelore.

Ogyst Konti i jep Monteskjës meritën e veçantë, që ka afirmuar determinizmin e fenomeneve historike dhe shoqërore. Ai i bën një interpretim të thjeshtëzuar “Frymës së ligjeve”, ideja qendrore e së cilës është shprehur në formulën e famshme të librit të parë të kësaj vepre: “Ligjet përbëjnë lidhjet e domosdoshme që rrjedhin prej natyrës së sendeve.” Ogyst Konti e kupton këtë formulim si parim të determinizmit të zbatuar njëherësh në diversitetin e fenomeneve shoqërore dhe në zhvillimin e shoqërive.

Nga ana tjetër, Monteskjë nuk do ta përfillte idenë e progresit për shkak se ka qenë themelues i sociologjisë. Ogyst Konti e zbulon këtë të Konderseja, në të famshmen “Skicë e një pasqyre historike të përparimit të mendjes njerëzore”,¹⁸ i cili pretendon të zbulojë në të kaluarën një numër fazash nëpër të cilat ka kaluar mendja njerëzore.

Këto faza janë në një numër të përcaktuar dhe rendi i tyre i njëpasnjëshëm është i nevojshëm. Ogyst Konti rimerr nga Konderseja idenë se përparimi i mendjes njerëzore është themeli i zhvillimit të shoqërive njerëzore.

Duke kombinuar temën e Monteskjës për determinizmin dhe temën e Kondersesë për etapat e nevojshme, sipas një rendi të pashmangshëm të progresit të mendjes njerëzore, fitojmë botëkuptimin qendror të Ogyst Kontit: fenomenet shoqërore i nënshtrohen një determinizmi rigoroz, që i paraqitet nën formën e një zhvillimi të pashmangshëm të shoqërive njerëzore të drejtuar nga përparimi i mendjes njerëzore.

Kjo mënyrë e të menduarit të zhvillimit historik shpie në një vizion të historisë, plotësisht të njësuar, që lëviz drejt një stadi të fundit të mendjes njerëzore dhe të shoqërive njerëzore shumë të krahasueshme, përfundimisht, me providencializmin e Bosyesë, të cilin Ogyst Konti e përshëndet si tentativën më të shquar që ka paraprirë të tijën:

“Sigurisht që me Bosyenë e madh duhet lidhur gjithmonë përpjekjen e parë të rëndësishme të mendjes njerëzore për ta kundruar, nga një pikëpamje mjaft e lartë, tërësinë e të kaluarës shoqërore. Pa dyshim, mundësitë e lehta, por iluzore, që i përkasin çdo filozofie teologjike për të krijuar njëfarë lidhje aparente ndërmjet ngjarjeve njerëzore, nuk lejojnë të përdorim sot për ndërtimin e drejtpërdrejtë të shkencës së vërtetë të zhvillimit shoqëror, shpjegime

që i karakterizonte në mënyrë të pashmangshme epërsia e një filozofie të tillë, së cilës atëherë nuk mund t'i bëhej ballë në këtë fushë. Mirëpo, ky kompozim i mrekullueshëm, ku mendja e gjithanshme, e domosdoshme për çdo konceptim të ngjashëm, është çmuar aq fort, madje dhe ruajtur aq sa ka lejuar natyra e metodës së përdorur, nuk do të mbetet përgjithmonë më pak se një shembull impozant, gjithnjë shumë i përshtatshëm për të shënuar qartë qëllimin e përgjithshëm, që pareshtur duhet vënë vetes inteligjenca jonë, në arritjen përfundimtare të të gjitha përimtimeve tona historike, dua të them në bashkërenditjen racionale të vargut themelor të ngjarjeve të ndryshme njerëzore, sipas një pikësnyimi unik, njëherësh më real dhe më të gjerë sesa ai i konceptuar nga Bosyeja." ("Kurs i filozofisë pozitiviste", vëll. IV, f. 147).

Formulimi "bashkërenditje racionale e vargut themelor të ngjarjeve të ndryshme njerëzore sipas një pikësnyimi unik" është çelësi i mendimit sociologjik të Ogyst Kontit. Ky është tamam sociolog i njerëzimit. Qëllimi i tij është ta reduktojë diversitetin e pakufishëm të shoqërive njerëzore, në hapësirë e në kohë, në një varg themelor të quajtur zhvillim i gjinisë njerëzore dhe në një plan unik, të quajtur arritje në stadin e fundit të mendjes njerëzore.

Po shihet kështu se si ai që konsiderohet themelues i shkencës pozitiviste, mund të paraqitet edhe si dishepull i fundit i providencializmit të krishterë; si mund të bëhet kalimi midis interpretimit të historisë nëpërmjet providencës dhe interpretimit të saj nëpërmjet ligjeve të përgjithshme. Qoftë kur bëhet fjalë për qëllimet e providencës, qoftë për ligjet e nevojshme të zhvillimit njerëzor, historia konceptohet si e domosdoshme dhe një. Qëllimi është unik, sepse atë e ka caktuar qoftë Zoti, qoftë natyra e njeriut; evolucioni është i domosdoshëm, meqenëse ose providenca ia ka caktuar etapat dhe fundin, ose vetë natyra e njeriut dhe e shoqërive ia ka caktuar ligjet.

Kështu, mendimi i Ogyst Kontit, edhe në "Kursin e filozofisë pozitiviste", ku ai paraqitet në formën më shkencore, kalon lehtë nga një konceptim shkencor në një version të ri të providencës.

Pikësnyimi unik i historisë i menduar nga Ogyst Konti është progresi i mendjes njerëzore. Kjo e njëson tërësinë e së kaluarës

shoqërore, sepse po kjo mënyrë e të menduarit duhet imponuar në të gjitha fushat.

Ogyst Konti, dihet, konstaton se metoda pozitiviste është sot e domosdoshme në shkencë dhe nxjerr përfundimin se kjo metodë e mbështetur mbi vështrimin, eksperimentimin dhe vendosjen e ligjeve, duhet të shtrihet në fushat që janë sot ende në duart e teologjisë ose të metafizikës, domethënë që shpjegohen qoftë nga qeniet transcendentë, qoftë nga entitetet ose shkaqet e fundit të fenomeneve. Ka një mënyrë të të menduarit të quajtur pozitivist, që ka një vlerë të përgjithshme si në politikë, ashtu edhe në astronomi.¹⁹

Përfundon në numrin e ardhshëm.

Shënime

1. Ogyst Konti e hartoi ligjin e tri stadeve në shkurt ose në mars të vitit 1822 dhe e botoi për herë të parë në *Prospekt i punimeve shkencore që nevojiten për të riorganizuar Shoqërinë*, i cili u publikua në prill 1822 në vëllimin e Sen- Simonit me titull *Vazhdim i punimeve shkencore që trajtojnë çështjen e themelimit të sistemit industrial*. Ky punim, të cilin Konti, në parathënien e *Sistemit të politikës pozitiviste*, do ta quajë *Broshurë themelore* dhe që ndonjëherë citohet si *Sistemi i parë i politikës pozitiviste*, sipas titullit të botimit të vitit 1824, do të ribotohej në vëllimin IV-t të *Sistemit të politikës pozitiviste* me titullin *Plani i punimeve shkencore që nevojiten për të riorganizuar Shoqërinë*.

Ligji i tri stadeve është objekt i leksionit të parë të *Kursit të filozofisë pozitiviste* (botimi i 5-të, vëll. I, f. 2-8), kurse klasifikimi i shkencave është objekt i leksionit të dytë të të njëjtit *kurs* (po aty, f. 32-63).

Mbi zbulimin e ligjit të tri stadeve dhe klasifikimin e shkencave shih veçanërisht: Henri Gouhier, *La jeunesse d' Auguste Comte et la formation du positivisme*, vëll. III, Ogyst Konti dhe Sen- Simoni, Paris, Vrin, 1941, f. 289-291.

2. “Duke studiuar zhvillimin e plotë të inteligjencës njerëzore në sferat e ndryshme të aktivitetit të saj, që nga fillimi i zhvillimit të saj më të thjeshtë deri në ditët tona, unë besoj se kam zbuluar një ligj themelor, të cilit ajo i është nënshtruar nga një nevojë e pandryshueshme, dhe i cili më duket fortësisht i mbështetur si mbi provat racionale të grumbulluara nga njohja e organizimit tonë, ashtu edhe mbi vërtetimet historike që rrjedhin nga një analizë e kujdesshme e së kaluarës. Ky ligj nënkupton atë që, secili nga konceptet tona bazë, çdo degë e njohjes sonë, kalon gradualisht nëpër tri stade të ndryshme teorike: stadi teologjik ose fiktiv; stadi metafizik ose abstrakt; stadi shkencor ose pozitivist. Me fjalë të tjera, mendja njerëzore, nga vetë natyra e saj, përdor në mënyrë të njëpasnjëshme, në çdo kërkim të saj, tri metoda filozofimi, karakteri i të cilave është thellësisht i ndryshëm e madje skajshmërisht i kundërt: në fillim metodën teologjike, më pas metodën metafizike dhe në fund metodën

pozitivistë. Këtu e kanë burimin tri lloje filozofish ose tri sisteme të përgjithshme të konceptimit të tërësisë së fenomeneve, të cilët përjashtojnë njëri –tjetrin: i pari është pikënisja e pashmangshme e inteligjencës njerëzore; i treti është gjendja e tij fikse dhe përfundimtare; i dyti është parapërcaktuar për të shërbyer si ndërmjetës.

Në stadin pozitivist, mendja njerëzore kupton pamundësinë e përfuturit të koncepteve absolute, heq dorë nga kërkimi i origjinës dhe drejtimit të universit, dhe nga njohja e shkaqeve të brendshme të fenomeneve, që të mundë të zbulojë, duke përdorur një kombinim të mirë të arsyes dhe vëzhgimit, ligjet e tyre të vërteta, pra ligjet e tyre të pandryshueshme të vazhdimësisë dhe ngjashmërisë. Shpjegimi i fakteve, i reduktuar në këtë moment në këto terma reale, s'është gjë tjetër veçse lidhja e vendosur ndërmjet fenomeneve të ndryshme të veçanta dhe disa fakteve të përgjithshme, numrin e të cilave progreset e shkencës synojnë ta zvogëlojnë gjithmonë e më shumë." (*Kursi i filozofisë pozitivistë*, vëll. I, f. 2-3.)

3. Konti shkruan: "Idetë drejtojnë dhe turbullojnë botën, ose, e thënë me fjalë të tjera, i gjithë mekanizmi social mbështetet përfundimisht mbi mendimet... Si përfundim, krizën e madhe politike dhe morale të shoqërive të sotme e shkarkon anarkia intelektuale. E keqja jonë më e madhe është, në fakt, ky mospajtim i thellë që ekziston tani midis gjithë njerëzve në lidhje me të gjitha maksimat themelore, pandryshueshmëria e të cilave është kushti kryesor për një rend të vërtetë social. Për aq kohë sa inteligjencat individuale nuk do të bashkohen për të miratuar njëzëri një numër të caktuar idesh të përgjithshme që mund të formojnë një doktrinë sociale të përbashkët, nuk mund ta fshehim që gjendja e kombeve do të mbetet patjetër thellësisht revolucionare, pavarësisht nga të gjitha politikat e ashtuquajtura lehtësuese që mund të përdoren, dhe do të çojë në të vërtetë vetëm në krijimin e institucioneve të përkohshme." (*Kursi i filozofisë pozitivistë*, vëll. I, f. 26.)

4. Ogyst Konti nuk e fsheh aspak rëndësinë e kësaj. "Jeta sociale nxjerr vetëm klasa të lidhura jo plotësisht me njëra- tjetrën, për

mungesë të një shtytje të përgjithshme për të bashkërenduar gjithçka pa prishur asgjë, gjë që përbën problemin thelbësor të qytetërimit modern. Zgjidhja e vërtetë do të jetë e mundur vetëm po të mbështetet në bashkimin qytetar.” (*Sistemi i politikës pozitiviste*, vëll. III, f. 364.) “Pas shfuqizimit të skllavërisë vetjake, masat proletare, pavarësisht nga çdo deklamim anarkik, nuk janë përfshirë aspak me të vërtetë në sistemin social; fuqia e kapitalit, fillimisht mjet natyror i emancipimit e më pas i pavarësisë, tani e kalon masën në transaksionet e përditshme, edhe pse ajo duhet domosdoshmërisht të ushtrojë një pushtet të drejtë, përpjesëtimisht me të përgjithshmen dhe përgjegjësinë më të lartë, duke ndjekur teorinë e shëndoshë të hierarkive. (*Kursi i filozofisë pozitiviste*, vëll. VI, f. 512.). “Çrregullimi bazë prek sot ekzistencën materiale, ku dy elementët e domosdoshëm të forcës drejtuese, pra numri dhe pasuria, jetojnë në një gjendje armiqësie të dyanshme në rritje, për të cilën duhen fajësuar të dy njësoj. (*Sistemi i politikës pozitiviste*, vëll. II, f. 391.)

5. Xhejms Burnham (James Burnham), *The Managerial Revolution*, Nju York, 1941, përkthyer në frëngjisht si *L'Ére des organisateurs*, Paris, Calmann- Lévy, 1947, me parathënie të Leon Blumit.

6. Analiza e natyrës dhe e objektit të ekonomisë politike nga Ogyst Konti gjendet në leksionin e dyzet e katërt të *Kursit të filozofisë pozitiviste* (vëll. IV, f. 138 v.). Ogyst Konti e kishte njohur dhe studiuar ekonominë politike të kohës së tij, pra ekonominë klasike dhe liberale, gjatë kohës që ishte sekretar i Sen – Simonit dhe në kritikën e tij ai hedh poshtë “rastin tej mase të jashtëzakonshëm të filozofit të shquar dhe të arsyeshëm Adam Smith”. Polemika e tij adresohet mbi të gjitha kundër pasuesve të Smithit: “Nëse ekonomistët tanë janë vërtet pasues të Adam Smithit, le të na tregojnë, pra, se si e kanë përmirësuar dhe plotësuar doktrinën e këtij mjeshtri të pavdekshëm, se çfarë zbulimesh vërtet të reja i kanë shtuar ata ideve të tij primitive, të cilat, përkundrazi, janë shtrembëruar tërësisht nga një ekspozim i kotë dhe foshnjarak i formave shkencore. Duke marrë në konsideratë, në mënyrë të paanshme, kundërshtimet shterpe që i përçajnë mbi nocionet më elementare të *vlërës, dobisë, prodhimit*, etj., nuk mund të

besoj se do të merrnim pjesë në debatet më të çuditshme sesa ato të skolasikëve të mesjetës për atributet themelore të entiteteve të tyre të pastra metafizike, karakterin e të cilave e marrin gjithmonë e më tepër konceptet ekonomike, për sa kohë që dogmatizohen dhe stërhollohen më shumë.” (Po aty, f. 141.) Por Konti i qorton kryesisht ekonomistët sepse duan të krijojnë një shkencë të pavarur, “relativisht të izoluar nga filozofia sociale”... “Sepse, për vetë natyrën e subjektit, në studimet sociale, si në të gjitha studimet që lidhen me qeniet e gjalla, aspektet e ndryshme të përgjithshme, pashmangësisht, të lidhura ngushtë me njëra- tjetrën dhe racionalisht të pandashme, janë të tilla që njëra nuk mund të na japë sqarimet e duhura për tjetrën. Kur e braktisim botën e entiteteve për t’iu afruar spekulimeve reale, bëhet e qartë që analiza ekonomike ose industriale e shoqërisë, pa marrë parasysh analizën e saj intelektuale, morale dhe politike, si në të shkuarën, ashtu edhe në të tashmen, nuk do të përfundohej pozitivisht: në mënyrë të tillë që, ndërsjellshëm, kjo ndarje irracionale të na jepte një shenjë të pakundërshtueshme të natyrës thelbësisht metafizike të doktrinave që bazohen mbi të.” (Po aty, f. 142.)

7. Moris Ale (Maurice Allais), profesor i ekonomisë në Fakultetin e Xehetarisë është autori i *Economie et intérêt*, Paris, Imprimerie Nationale, 1947, 2 vëll.; *Traité d’ économie pure*, Paris, Imprimerie Nationale, 1952; *Economie pure et rendement sociale*, Paris, Sirey, 1945; *L’Europe unie route de la prospérité*, Paris, Calmann- Lévy 1960 ; *Les Tiers Monde au carrefour*, Bruxelles, Les Cahiers africains, 2 vëll., 1963.

8. Alfred Sovi (Alfred Sauvy), profesor në Kolegjin e Francës, është autor i disa veprave, ndër të cilat përmendim: *Théorie générale de la population*, Paris, P.U.F., vëll. I, 1963, vëll. II, 1959; *La nature sociale*, Paris, Armand Colin, 1957; *De Malthus à Mao Tse-toung*, Paris, Denoël, 1958; *La montée des jeunes*, Paris, Calmann- Levy, 1953; *Le Plan Sauvy*, Paris, Calmann- Lévy, 1960 ; *Mythologies de notre temps*, Paris, Payot, 1965; *Historie économique de la France entre les deux guerres, t. I. De l’armistice à la dévaluation de la livre*, Paris, Fayard, 1965.

9. Konti shkruante kështu: “Pasi të ketë shpjeguar ligjet natyrore, të cilat, në sistemin e marrëdhënieve shoqërore moderne, duhet të përcaktojnë përqendrimin e domosdoshëm të pasurive midis krerëve industrialistë, filozofia pozitiviste do të tregojë që pak i intereson masave popullore se në cilat duar gjenden zakonisht kapitale, mjaft që përdorimi i tyre i natyrshëm të jetë vërtet i dobishëm për masat sociale. Ose, ky kusht thelbësor varet, për nga vetë natyra e tij, shumë më tepër nga mjetet morale sesa nga masat politike. Vizionet e ngushta dhe pasionet për të urryer, në mënyrë të ligjshme, do t’i kishin vënë pengesa të mëdha grumbullimit spontan të kapitaleve, duke rrezikuar të paralizonin drejt për drejt çdo aktivitet të vërtetë social, është e qartë se këto procedura tiranike do të kishin pasur realisht shumë më pak efikasitet sesa dënimi universal, që zbaton morali pozitivist ndaj çdo shfrytëzimi me egoizëm të pasurive të zotëruara; dënim, të cilit për më tepër nuk mund t’i rezistosh, kur vetë ata që do të duhej ta pësonin, nuk mund t’ia hedhin poshtë parimin, që u është ngulitur të gjithëve nga edukimi bazë i përbashkët, siç e ka treguar katolicizmi në periudhën e mbisundimit të vet. (...) Por, duke ia shpalosur popullit natyrën thellësisht morale të kërkesave të tij më të rëndësishme, e njëjta filozofi do t’u japë të kuptojnë klasave superiore peshën e një gjykimi të tillë, duke iu imponuar energjikisht, në emër të parimeve që nuk mund të kundërshtohen haptazi, detyrimet morale të pozicionit të tyre; në mënyrë që, për shembull, për shkak të pronës, të pasurit të konsiderohen moralisht si depozituesit e domosdoshëm të kapitaleve publike, përdorimi efektiv i të cilave, pa marrë mbi vete asnjë përgjegjësi politike, me përjashtim të ndonjë rasti të jashtëzakonshëm gabimi ekstrem, të mos mbetet gjithmonë vetëm në trajtën e një debati skrupuloz moral, domosdoshmërisht i shfrytëzueshëm nga të gjithë në kushtet e duhura, dhe autoriteti shpirtëror i të cilit do të përbëjë më vonë organin e natyrshëm. Sipas një studimi të thelluar të evolucionit modern, filozofia pozitiviste do të tregojë që, pas shfuqizimit të skllavërisë vetjake, masat proletare, pavarësisht nga çdo deklamim anarkik, nuk janë përfshirë aspak me të vërtetë në sistemin social; fuqia e kapitalit, fillimisht mjet natyror i emancipimit e më pas i pavarësisë, tani e kalon masën në transaksionet e përditshme; edhe

pse ajo duhet domosdoshmërisht të ushtrrojë një pushtet të drejtë, për shkak të shumicës dhe përgjegjësisë më të lartë, duke ndjekur teorinë e shëndoshë të hierarkive. Me pak fjalë, kjo filozofi do të bëjë të qartë që marrëdhëniet industriale, në vend që të mbeten pronë e një empirizmi të rrezikshëm ose e një antagonizmi shtypës, duhet të sistematizohen sipas ligjeve morale të harmonisë universale (*Kursi i filozofisë pozitiviste*, vëll. VI, f. 357-358.).

10. Mora (Maurras) ka shkruar një ese mbi Ogyst Kontin, e cila u botua bashkë me esetë e tjera *Le Romantisme féminin, Mademoiselle Monk* në vijim të *L' Avenir de L'intelligence*, Paris, Nouvelle Librairie Nationale, 1918. Mora shkruante për Kontin: "Nëse zotat ekzistojnë vërtet, nëse nuk është e vërtetë që qielli dhe toka deh mjetet për t'i interpretuar këto kanë ardhur në botë vetëm ditën e lindjes sonë, unë nuk njoh asnjë emër tjetër njeriu që duhet shqiptuar me një ndjenjë kaq të gjallë mirënjohjeje. Imazhi i tij nuk mund të na vijë ndërmend pa u emocionuar. Disa prej nesh ishin një anarki e gjallë. Ai na ktheu rregullin ose atë që vllente, shpresën për rregullin. Ai na tregoi fytyrën e bukur të bashkimit, që buzëqeshte nga një qiell që nuk dukej tepër i largët."

11. Referimet te Konti i gjejmë në të gjithë veprën e Alenit. Shih veçanërisht: *Propos sur le christianisme*, Paris, Rieder, 1924; *Idées*, Paris, Hartmann, 1932, ribotuar në koleksionin 10-18, Paris, Union Générale d' Éditions, 1964 (ky vëllim i fundit përmban një studim kushtuar Kontit).

Politika e Alenit është paraqitur në dy vëllime: *Éléments d'une doctrine radicale*, Paris, Gallimard, 1925; *Le Citoyen contre les pouvoirs*, Paris, S. Kra, 1926.

12. Unë kam trajtuar subjektin e luftës në mendimin e Ogyst Kontit në *La Société industrielle et la guerre*, Paris, Plon, 1959; pikërisht në esenë e parë, "Auguste Comte Memorial Lecture", mbajtur në Shkollën e Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër.

13. Para shumë vitesh, unë mora pjesë në një juri për vlerësimin e një teze kushtuar Alenit nga një njeri që kishte përqafuar pozitivizmin prej mësimave të tij, dhe i cili kishte dështuar në hedhjen poshtë të mësimave të Alenit dhe të Ogyst Kontit kur shpërtheu lufta e vitit 1939. Profeti i rremë, ai shpallte paqen në një shekull lufte!

14. Ogyst Konti shkroi në një epokë kalimtare të historisë së kolonive: në momentin kur perandoritë e krijuara që në shekullin XVI pranojnë të shkrihen në shekullin XVIII dhe në prag të krijimit të perandorive të shekullit XIX. Shkëputja e kolonive amerikane të Spanjës u pranua, Britania e Madhe humbi kolonitë e saj kryesore në Amerikën e Veriut dhe Franca Indinë, Kanadanë dhe Santo Domingon. Ndërkaq Britania e madhe mbajti perandorinë e saj të Azisë dhe Kanadasë. Nga viti 1829 deri në vitin 1842, periudhë gjatë së cilës Konti hartoi *Kursin e filozofisë pozitiviste*, Franca fillon të krijojë perandorinë e saj të dytë koloniale duke pushtuar Algjerinë dhe duke fituar pikat e mbështetjes në brigjet e Afrikës dhe në Oqeani. Britania e Madhe veproi në të njëjtën mënyrë duke marrë në zotërim në vitin 1840 Zelandën e Re.

Ja se si e gjykon Konti sistemin kolonial të shekujve XVII dhe XVIII: "Pa iu kthyer aspak shkrimeve deklamative të shekullit të kaluar, respektivisht për përparësinë ose për rrezikun përfundimtar që mbart ky operacion i gjerë për tërësinë e njerëzimit, që është një çështje sa e kotë, po aq edhe e pazgjdhshme, do të ishte me interes të shqyrtonim nëse si rrjedhim do të kemi ndonjë përshpejtim apo vonesë të të gjithë zhvillimit, njëherazi pozitiv dhe negativ, të shoqërive moderne. Në këtë këndvështrim, duket fillimisht sikur drejtimi kryesor që i është hapur kështu frymës luftarake, mbi tokë dhe mbi det, dhe acarimi i rëndësishëm që i është imponuar në mënyrë të ngjashme frymës fetare, si më e përshtatura me qytetërimin e popullsisë të prapambetura, ia dolën të zgjasin drejtpërdrejt jetëgjatësinë e regjimit ushtarak dhe teologjik, dhe, në vazhdim, ia arritën të shmangin veçanërisht riorganizimin përfundimtar. Por, në radhë të parë, shtrirja totale, që sistemi i marrëdhënieve njerëzore ka synuar që atëherë të përftojë gradualisht, bëri që të kuptohej më mirë natyra e vërtetë të filozofisë së një ri-integrimit të tillë, duke e paraqitur

si plotësisht të paracaktuar për tërë njerëzimin; gjë që vuri më shumë në dukje pamjaftueshmërinë e skajshme të një politike të drejtuar, në shumë raste, për të shkatërruar sistematikisht racat njerëzore, në pamundësi për të realizuar përngjashmimin e tyre. Në radhë të dytë, me një ndikim më të drejtpërdrejtë e të afërt, nxitja e re aktive që kjo ngjarje e madhe evropiane i ka imponuar kudo industrisë, sigurisht që e ka rritur së tepërmi rëndësinë e saj sociale dhe madje edhe politike: në mënyrë të tillë që, i kompensuar plotësisht, zhvillimi modern ka pësuar, për mendimin tim, një përshejtim të vërtetë, për të cilin megjithatë formohet zakonisht një opinion tepër i ekzagjeruar.” (*Kursi i filozofisë pozitivistë, vëll. VI, f. 68.*)

Konti analizon pushtimet koloniale të shekullit XIX me këto fjalë: “Ne kemi vënë re, është e vërtetë, [...] futjen spontane të një sofizmi të rrezikshëm, që sot po përpiqen ta përforcojnë, i cili synon të ruajë përgjithmonë aktivitetin ushtarak, duke i caktuar pushtimeve të njëpasnjëshme drejtimin mashtrues për të treguar haptazi epërsinë materiale të popullsisë më të përparuar mbi ato më pak të përparuara, që është gjëja më pak e dobishme për qytetërimin universal. Në stadin e mjerë të filozofisë së sotme politike, që lejon ndikimin kalimtar të çfarëdolloj çmendurie, një prirje e tillë sigurisht që ka shumë peshë si burim i turbullimit universal; duke ndjekur rrjedhën logjike, ajo, pa dyshim, pasi të ketë motivuar shtypjen reciproke të kombeve, do të çojë në vërsuljen drejt njëri-tjetrit të qyteteve të ndryshme, sipas përparimit të tyre të pabarabartë social; dhe, pa arritur deri në këtë shtrirje të ashpër, që duhet të mbetet gjithmonë ideale, është në fakt pikërisht ky preteksti që u nxor për të sajuar justifikimin e urryer të skllavërisë koloniale, duke mbështetur epërsinë e pamohueshme të racës së bardhë. Por, pavarësisht nga çrregullimet e rënda që mund të nxisin aktualisht një sofizëm të tillë, instinkti karakteristik i marrëdhënieve shoqërore moderne duhet sigurisht të largojë çdo shqetësim irracional që do të përpiqej të gjente aty, madje edhe për një të ardhme të afërt, një burim të ri luftërash të përgjithshme, tërësisht të papajtueshme me dispozitat më ngulmuese të të gjitha popullsisë të qytetëruara. Përpara formimit dhe përhapjes së filozofisë së shëndoshë politike, gjykimi i saktë popullor, pa dyshim, do ta ketë vlerësuar siç duhet, edhe pse sipas një empirizmi konfuz, këtë imitim

trashanik të përmbysur të politikës së madhe romake, që ne kemi parë, në drejtim të kundërt, në thelb të caktuar, në kushte sociale skajshmërisht të kundërta me ato të mjedisit modern për të shtypur kudo, ndofta me përjashtim të ndonjë populli unik, zhvillimin kërcënues të jetës ushtarake, që kjo parodi e kotë do të stimulonte, përkundrazi, te kombet që për një kohë të gjatë kanë ushtruar një aktivitet tërësisht paqësor.” (*Kursi i filozofisë pozitiviste*, vëll. VI, f. 237-238.).

15. Te Ogyst Konti gjejmë formula të shumta që pohojnë anakronizmin e luftërave, duke theksuar kontradiktën ndërmjet shoqërisë moderne dhe fenomeneve ushtarake dhe luftarake: “Të gjitha ato qenie që kanë shpirtin e vërtetë të filozofimit duhet ta pranojnë me lehtësi, me një kënaqësi të përkryer, se më në fund ka ardhur koha që lufta serioze dhe e zgjatur të zhduket tërësisht nga elita e njerëzimit.” (*Kursi i filozofisë pozitiviste*, vëll. VI, f. 239.). Ose më tej: “Të gjitha mjetet e ndryshme të përgjithshme të analizës racionale, të përdorshme në kërkimet politike, kanë ndihmuar spontanisht, në një mënyrë gjithashtu vendimtare, për të konstatuar prirjen e pashmangshme të njerëzimit për një jetë kryesisht ushtarake dhe për drejtimin e saj përfundimtar, jo më pak të pashmangshëm, për një ekzistencë thellësisht industriale. Kështu, asnjë inteligjencë disi e përparuar nuk mund të mos pranojë tashmë, pak a shumë shprehimisht, rënien e vazhdueshme të frymës ushtarake dhe rritjen e frymës industriale, si një pasojë e dyfishtë e domosdoshme e zhvillimit tonë përparimtar, që në ditët tona, është gjykuar me kaq kritikizëm, në këtë këndvështrim, nga pjesa më e madhe e atyre që merren seriozisht me filozofi politike. Në një kohë kur, veç të tjerash, neveria karakteristike e shoqërive moderne për luftën po manifestohej vazhdimisht, në forma gjithmonë e më të ndryshme dhe me një energji gjithmonë në rritje, madje edhe në vetë gjirin e ushtrive; kur, për shembull, pamjaftueshmëria totale e vokacioneve ushtarake është bërë kudo gjithmonë e më e pamohueshme për shkak të nevojës përherë e më të domosdoshme për të rekrutuar me forcë, rrallë e shoqëruar nga ndonjë këmbëngulje vullnetare; përvoja e përditshme do ta lironte pa dyshim, nga çdo demonstrim i drejtpërdrejtë, për

shkak të një koncepti të bërë po kaq gradualisht pronë publike. Pavarësisht nga zhvillimi i madh i veçantë i aktivitetit ushtarak, përkohësisht i përcaktuar, në fillimet e këtij shekulli, për shkak të forcës së pashmangshme që pasoi rrethanat e papërballueshme jonormale, instinkti ynë industrial dhe paqësor nuk vonoi të merrte, me shumë shpejtësi, kursin normal të zhvillimit të tij mbizotërues, në mënyrë që të sigurohej realisht qetësia përfundimtare e botës së qytetëruar, edhe pse harmonia evropiane duket shpesh e kompromentuar, si pasojë e mangësive të përkohshme të çdo organizimi sistematik të marrëdhënieve ndërkombëtare; gjë që, edhe pse mund të mos sjellë me të vërtetë luftën, mjafton për të shkaktuar shpesh shqetësime të rrezikshme. [...] Ndërkohë që aktiviteti industrial paraqet në mënyrë spontane aftësinë e tij për t'u stimuluar njëkohësisht ndër të gjithë individët dhe ndër të gjithë popujt, pa ndodhur që zhvillimi i njërit të jetë i papajtueshëm me atë të tjerëve, është e qartë që plotësia e jetës ushtarake në një pjesë të konsiderueshme të njerëzimit, përkundrazi, të nënkuptoje dhe të përcaktojë përfundimisht, një shtypje të pashmangshme për pjesën tjetër që përbën shërbimin kryesor social të një regjimi të tillë, duke pasur parasysh të gjithë botën e qytetëruar. Kështu, për sa kohë që epoka industriale nuk ka asnjë afat tjetër të përgjithshëm, përveç atij, ende të papërcaktuar, të dhënë për ekzistencën progresive të species sonë nëpërmjet sistemeve e ligjeve natyrore, epokës ushtarake, domosdoshmërisht, i është dashur të kufizohet vetëm në përmbushjen graduale të mjaftueshme të kushteve paraprake, të cilat ajo ishte paracaktuar të realizonte." (*Kursi i filozofisë pozitivistë, vëll. IV, f. 375 dhe 379.*)

16. "Pasuritë tona materiale mund të na ikin nga duart me dëshirë ose me forcë. Në rastin e parë, transmetimi është herë falas herë me interes. Në mënyrë të ngjashme, shpërngulja e padëshiruar mund të jetë ose me dhunë ose e ligjshme. Si përfundim, të tilla janë të katër mënyrat e përgjithshme sipas të cilave transmetohen normalisht produktet materiale.... Në bazë të rëndësisë dhe efikasitetit të tyre në rënie ato duhet të renditen normalisht sipas kësaj radhe: dhurimi, shkëmbimi, trashëgimia dhe pushtimi. Dy metodat e mesit janë të

vetmet që janë bërë zakon në popullsitë moderne, si të përshtaturat më mirë me ekzistencën industriale që i provoi ato. Por të dy ekstremet konkurruan paraprakisht për formimin fillestar të kapitaleve të mëdha. Megjithëse të fundit iu desh t'i nënshtrohej përfundimisht braktisjes totale, nuk do të ndodhë kurrë e njëjta gjë me të parin, rëndësinë dhe pastërtinë e të cilit nuk e vlerësojmë për shkak të egoizmit tonë industrial... E sistematizuar nga pozitivizmi, prirja për të dhuruar do t'i japë regjimit përfundimtar një prej ndihmesave më të mira të përkohshme me anë të veprimtimit të vazhdueshëm të pushtetit të vërtetë shpirtëror, për ta bërë pasurinë njëherazi më të vlefshme dhe më të respektuar. Më e vjetra dhe më fisnikja nga të gjitha metodat e mirëfillta të transmetimit material do ta ndihmojë shumë organizimin tonë industrial, gjë që nuk mund ta tregojë metafizika e zbrazët e ekonomistëve tanë të paskrupullt. (*Sistemi i politikës pozitiviste*, vëll. II, f. 155-156.)

Do ta krahasojmë këtë tekst me të tilla analiza moderne veçanërisht me Fransua Peru (François Perroux), "*Le don, sa signification économique dans le capitalisme contemporaine*", Diogenë, prill 1954, artikull i ribotuar në *L'Économie du XX^e siècle*, bot. I, Paris, P.U.F., 1961, f. 322-344.

17. Majkëll Jang (Michael Young), *The Rise of Meritocracy*, Londër, Thames and Hudson, 1958; Penguin Books, 1961.

18. Kondorse (Condorcet), *Esquisse d'un tableau historique des progrès de l'esprit humain*. Kjo vepër, e shkruar më 1793, u botua për herë të parë në vitin III. Për një botim modern, shih atë të Bibliotekës së Filozofisë, Paris, Boivin, 1933. Përpara Kondorsesë, Tyrgo kishte shkruar *Tableau philosophique des progrès successifs de l'esprit humain*.

19. Këtu e ka burimin konkluzioni i Ogyst Kontit se, përderisa nuk ka liri arsyeje në astronomi, nuk duhet të ketë një të tillë as në politikë.